

Nr. 1846 Prot

Durrës, më: 01.08.2025

V E N D I M

Nr. 85, datë 01.08.2025

PËR

"MIRATIMIN E KALENDARIT "PËR APLIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE ME DIPLOMË TË HUAJ, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; në Vendimin Nr. 436, datë 03.06.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim", i ndryshuar; në Udhëzimin e MAS me Nr. 12, datë 30.06.2023 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë"; në Urdhërin e përbashkët QSHA & RASH me Nr. 157, datë 03.06.2025 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2025-2026"; në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; në "Strategjinë Afatshkurtër për procedurën e rekrutimit të studentëve të huaj në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, për vitin akademik 2025-2026", miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 79, datë 08.07.2025, si dhe në shkresën me Nr. 1838 prot., datë 31.07.2025 të Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kalendarit "Për aplikimin dhe regjistrimin e kandidatëve me diplomë të huaj, në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, për vitin akademik 2025-2026", sipas tabelës nr. 1 dhe tabelës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Drejtoria e Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave
 - Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit
 - Komisioni *ad-hoc* për ndjekjen e procedurës së rekrutimit të studentëve të huaj në UAMD
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI



Tabela Nr. 1

Mbi afatet e përcaktuara për aplikimet dhe regjistrimet nga kandidatët me diplomë të huaj të arsimit të mesëm të lartë, në ciklin e pare te studimeve 2025-2026	
➤ Kandidatët me diplomë të huaj të arsimit të mesëm të lartë, që dëshirojnë të ndjekin studimet në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, aplikojnë pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës	Deri më 24 Shtator 2025
➤ Komisionet e Njësive Kryesore kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kriterëve të përcaktuara për çdo program studimi dhe pas përfundimit të përzgjedhjes së studentëve fitues publikojnë në mjediset të dukshme dhe në faqen elektronike zyrtare duke respektuar mbrojtjen e të dhënave personale, listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes	Nga data 25 Shtator deri më datë 30 Shtator 2025.
➤ Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues . Regjistrimi i kryer konsiderohet përfundimtar dhe kandidati nuk mund të heqë dorë për tu regjistruar në një program tjetër studimi.	Deri më datë 24 Tetor 2025.
➤ Sekretariatë mësimore në njësitet kryesore për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi,	Nga data 20 Tetor deri më datë 24 Tetor 2025.

Tabela Nr. 2

Mbi afatet e përcaktuara për aplikimet dhe regjistrimet nga kandidatët me diplomë të huaj në ciklin e dytë të studimeve Master Profesional dhe Master i Shkencor 2025-2026	
➤ Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë, me përjashtim të programeve të integruara të ciklit të dytë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, për vitin akademik 2025-2026 do të bëhen pranë sekretarive mesimore të njësive kryesore.	<i>Deri më datë 03 tetor 2025</i>
➤ Njësitë Kryesore afishojnë listat e kandidatëve fitues në vende të dukshme si dhe në faqen elektronike zyrtare (web) të UAMD-së të ndarë sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga kandidatët, në përputhje me kuotat e pranimeve të miratuara.	<i>Brenda datës 17 tetor 2025</i>
➤ Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mesimore përkatëse të Njësive Kryesore	<i>Deri më datë 27 Tetor 2025.</i>
➤ Njësitë Kryesore shpallin në vende të dukshme dhe publikojnë në faqen elektronike zyrtare (web), listën emerore të kandidatëve të regjistruar brenda	<i>Datës 31 Tetor 2025.</i>